

## **Pyetje dhe përgjigje të përgjithshme rreth Ofertës publike:**

### **1. E pranoj Ofertën! Çfarë duhet të bëj?**

Nuk duhet të bëni asgjë. Pas kalimit të ditës së 10-të do të zbatohen masat e shpallura.

### **2. Nuk e pranoj Ofertën! Çfarë duhet të bëj?**

Duhet të na dërgoni një njoftim: Në formë elektronike duke plotësuar formularin në këtë link <https://www.kb.com.mk/Default.aspx?sel=2310&lang=1&uc=47> ose me shkrim/me postë në adresën: rr. Orce Nikolov nr. 3, 1000 Shkup, me shënim “Refuzim i Ofertës publike numër 09-600-15831/1”.

### **3. Kam problem me verifikimin gjatë paraqitjes për të plotësuar formularin për refuzim. Çfarë duhet të bëj?**

Kontrolloni nëse në fushën e llogarisë së transaksionit jeni duke shënuar saktësisht 15 shifrat e kërkuara të llogarisë Tuaj të transaksionit në Bankë.

Kontrolloni nëse janë të sakta numrat që jeni duke i shënuar si 6 shifrat e fundit të numrit Tuaj amë (NUAQ).

Kontrolloni nëse jeni duke i shënuar saktë karakteret nga kodi i fotos/figurës (të vogla, të mëdhaja, shkronja dhe numra).

Nëse akoma vazhdoni të keni problem me verifikimin, ju lutemi na shkruani një porosi në e-mailin: [merki-covid19@kb.com.mk](mailto:merki-covid19@kb.com.mk)

### **4. Si do të më konfirmojë banka se e ka pranuar njoftimin tim?**

Përmes vërtetimit në llogarinë Tuaj të transaksionit dhe përmes Internet Bankës Tuaj.

### **5. A mundet për një produkt ta pranoj dhe për një tjetër të mos e pranoj Ofertën?**

Mundet. Ju duhet të deklaroni se për cilin produkt nuk e pranoni Ofertën dhe të vazhdoni me pagesën e rregullt.

### **6. A do të llogaritni interes të interesit të kapitalizuar gjatë periudhës grejs?**

Banka nuk do të llogarisë interes të interesit të kapitalizuar gjatë periudhës grejs.

### **7. A mund ta ndryshoj mendimin brenda 10 ditëve?**

Ju mund të ndryshoni mendimin tuaj, për çka do të duhet të korrigjoni se për cilat produkte ju ndryshoni mendjen tuaj dhe të na njoftoni për këtë në formë elektronike ose me shkrim përmes postës.

### **8. A mund ta ndryshoj mendimin pas kalimit të afatit prej 10 ditëve?**

Për këtë pyetje do të duhet të drejtoheni me shkrim/personalisht në Bankë.

## **9. Cilët klientë mund ta pranojnë Ofertën?**

Klientët të cilët kanë produkte të kredisë në Bankë me ekspozim kreditor të klasifikuar në kategorinë e rrezikut shkronja "A", "B" dhe "C" të rregullt deri më dt. 29.02.2020, respektivisht klientët të cilët në asnjë bazë nuk kanë detyrime të papaguara të kredisë për më shumë se 90 ditë deri më dt. 29.02.2020.

### **Pyetje dhe përgjigje rreth kredive për personat fizikë**

#### **1. Si mundet klientët ta kuptojnë se cilës kategori të rrezikut i takojnë?**

Nëse deri më tani keni qenë të rregullt në pagesat tuaja drejt Bankës dhe keni shlyer detyrimet tuaja në afatin e paraparë ose me vonesë maksimum deri në 90 ditë, atëherë shkronja Juaj e klasifikimit është A, B ose C. Në FORMULARIN për refuzim elektronik të Ofertës, Banka jua shfaq vetëm nën-llogaritë Tuaja që e plotësojnë kushtin e Ofertës.

#### **2. Ju lutem të më përgatisni një plan amortizimi nëse unë e shtyj pagesën e kësteve për 6 muaj, për të krahasuar nëse më përshtatet të shtyj pagesën apo jo.**

Përgatitja e planit të amortizimit individualisht për klientët, në këtë kohë nuk është e mundur. Interesit dhe shumën e kështit të ri mujor mundeni ta llogaritni vetë në kalkulatorin **për llogaritje informative të kështit mujor pas kalimit të periudhës grejs 6 mujore për kredi**, në këtë link: <https://www.kb.com.mk/Default.aspx?sel=2370&lang=1&uc=1>

Shënoni të dhënat për kredi nga plani Juaj i amortizimit:

- Në fushën „Shuma“ shënoni – principalin e pamaturuar nga 16.03.2020.
- Në fushën „Këstet“ i shënoni këstet e mbetura mujore deri në afatin e fundit të shlyerjes. Nëse keni kredi me më shumë norma të interesit (fikse/të ndryshueshme) në fushën “numri i muajve me periudhë fikse”, e shënoni numrin e muajve sa Ju mbesin nga periudha fikse.
- Në fushën e fundit e shënoni normën e ndryshueshme të interesit.

#### **3. Nëse në rast të refuzimit të Ofertës për periudhën grejs për kredi, respektivisht nëse këstet vazhdojnë edhe më tej të paguhen siç vijnë për pagesë, a do të ulet interesi gjatë kësaj periudhe apo do të ngelet i njëjtë sipas Marrëveshjes aktuale.**

Nëse e refuzoni Ofertën, vazhdoni me pagesën e rregullt të kredisë në përputhje me normën aktuale të interesit të parashikuar në Marrëveshjen Tuaj për kredi.

#### **4. Jam shfrytëzues i produkteve të kredisë në Bankë. Dua ta refuzoj Ofertën, por nuk e di më tutje, pas një ose dy muaj, nëse do të kem një rrogë të zvogëluar ose vështirësi financiare për pagesën e detyrimit mujor. A mundet përsëri të parashtrahet kërkesë për ri-programim në përputhje me Ofertën?**

Nëse tani e refuzoni Ofertën, nuk mundeni më vonë të kërkonit riaktivizimin e masave. Oferta është e vlefshme 10 ditë prej shpalljes, pra deri në 09.04.2020, deri në orën 16:00. Nëse nuk jeni të sigurt për mundësinë e pagesës në të ardhmen, ju mundeni ta pranoni Ofertën dhe të vazhdoni me pagesë të pavarur të kredisë në periudhën grejs, ku këto mjete të paguara do të kenë trajtim në përputhje me pikën 5 të Ofertës për kredi në linkun në vijim: <https://www.kb.com.mk/Default.aspx?sel=2370&lang=1&uc=1> .

Për pranim të Ofertës nuk ka nevojë të na njoftoni.

## **5. Me çfarë norme interesi llogaritet interesi gjatë periudhës grejs?**

Për gjithë kohëzgjatjen e periudhës grejs, Banka do të llogarisë interes sipas normës së interesit të parashikuar në Marrëveshjen e kredisë, por nuk do të evidentojë interesin në nën-llogarinë kreditore. Pas mbarimit të periudhës grejs të parashikuar prej 6 (gjashtë) muaj, interesi i përlllogaritur në periudhën grejs do të shtohet në saldon e kredisë dhe do të shpërndahet për pagesë në mënyrë të barabartë në këstet në përputhje me planin e ri të amortizimit. Afati i shlyerjes vazhdohet për 6 muaj. Banka nuk do të llogarisë interes në interesin e kapitalizuar.

## **6. A do të jetë aktiv urdhëri periodik për pagesë të kësteve mujore gjatë periudhës grejs?**

Gjatë periudhës grejs, urdhëri periodik dhe rezervimet për pagesa të detyrimeve të kredisë do të vihen në pritje.

## **7. Kredinë e paguaj me ndalesë administrative, a do të vihet kjo në pritje nëse e pranoj Ofertën? Punëdhënësi kërkon vërtetim nga Banka.**

Nëse kredia Juaj paguhet me ndalesë administrative, Ju lutemi të njoftoni punëdhënësin Tuaj me deklaratë personale me shkrim se keni pranuar ofertë për periudhë grejs 6 mujore dhe që ta vejë në pritje të njëjtën. Nëse përsëri do t'ju ndalet kësti mujor, i njëjti, në marrëveshje me Bankën, do t'ju kthehet në llogarinë Tuaj ose mund të përdoret për të ulur saldon tuaj të kredisë pas mbarimit të periudhës grejs. Në këtë situatë ne nuk jemi në gjendje të japim vërtetime individuale për secilin klient.

## **8. A vlen Oferta për kreditë e shfrytëzuara në muajin mars 2020?**

Kreditë e marra në mars 2020 nuk janë përfshirë në Ofertë, duke marrë parasysh kriteret e parashikuara nga organet kompetente. Por, Banka së shpejti do të ofrojë masa edhe për këto kredi (për personat fizikë të cilët do të kenë nevojë për lehtësime), për çka do t'ju njoftojmë në mënyrë plotësuese.

## **9. Nëse pranoj ofertën për ri-programim të kredisë dhe pas 3 muajsh kam mundësi të bëj pagesë të këstit mujor, a mund të vazhdoj me shlyerjen e kredisë?**

Gjatë kohës së periudhës grejs Ju mundeni të bëni pagesa të kredisë, por të gjitha pagesat, nëse nuk keni prej më parë detyrime të maturuara, do të kenë trajtim të pagesës avans dhe do të përdoren për ulje të saldosit të kredisë pas mbarimit të periudhës grejs, për çka do t'ju përgatitet plan i ri i amortizimit.

## **10. A mund të likuidohet kredia gjatë periudhës grejs?**

Gjatë periudhës grejs, kredia mund të likuidohet. Në ditën e pagesës, Banka do të japë një llogaritje për shlyerjen e plotë të kredisë dhe do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Marrëveshjen për kredi.

## **11. Jam shfrytëzues i produkteve të kredisë në Bankë, por gjatë shënimit të të dhënave të mia në formularin për refuzim të Ofertës publike, sistemi më jep porosi kthyesë se nuk ka produkt që i plotëson kriteret sipas shpalljes.**

Oferta vlen vetëm për shfrytëzuesit e produkteve të kredisë të cilët më 29.02.2020 kanë ekspozim kreditor të klasifikuar në shkronjë të rrezikut A, B ose C. Oferta nuk vlen për

shfrytëzuesit të cilët kanë produkt kreditor të klasifikuar në kategori tjera më të rrezikuara të rrezikut (C jofunksional, Ç ose D) ose me ekspozim kreditor të miratuar ose të shfrytëzuar gjatë muajit mars 2020.

**12. Kam më shumë nën-llogari kreditore në Bankë. Për një pjesë të tyre dua të vazhdoj me pagesën e rregullt, ndërsa për një pjesë tjetër dua ri-programim për 6 muaj. A është kjo e mundshme?**

Po, mundet në afat prej 10 ditëve nga shpallja e Ofertës publike, të zgjidhni në formë elektronike për cilat nën-kredi po refuzoni Ofertën. Të gjitha nën-llogaritë tjera të cilat nuk do ti shënoni në njoftimin elektronik, do të llogariten se i keni pranuar në Ofertën për ndryshim të kushteve kontraktuale.

**13. Nëse kam kredi me një normë fikse të interesit që skadon gjatë periudhës grejs prej 6 muajsh, me afatin e vazhduar të shlyerjes së kredisë a do të më vazhdohet edhe periudha fikse?**

Jo, në 6 muajt e prolonguara do të llogaritet interes me normë të ndryshueshme të interesit që Ju është parashikuar në përputhje me marrëveshjen e kredisë.

**14. A mundet një sqarim rreth interesit për atë periudhë grejs prej 6 muajsh. Meqenëse kësti mujor tashmë është i përbërë nga pjesa kryesore dhe interesi, në cilën vlerë do të llogaritet interes shtesë për këtë periudhë 6-mujore? A do të thotë kjo që të gjithë do të kemi një rritje në pjesën e mbetur të pagesës?**

Nëse nuk e refuzoni Ofertën publike, për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës grejs, Banka do të llogarisë interes sipas normës së interesit të parashikuar në Marrëveshjen e kredisë, respektivisht nuk do të ketë interes shtesë, por vetëm interes të rregullt. Pas mbarimit të periudhës grejs të parashikuar prej 6 (gjashtë) muaj, interesi i përlllogaritur në periudhën grejs do të kapitalizohet (shtohet) në bilancin/saldon e kredisë dhe do të shpërndahet për pagesë në mënyrë të barabartë në këstet në përputhje me planin e ri të amortizimit. Po, kjo do të thotë që do të ketë një rritje të vogël të kësteve për pjesën e mbetur të pagesës, por në të njëjtën kohë do të prolongohet edhe afati i shlyerjes së kredisë, me çka mundësohet që rritja e këstit të jetë minimal, ku ju janë ofruar edhe disa shembuj informues për kredi në fund të Ofertës publike (linku:

<https://www.kb.com.mk/Default.aspx?sel=2370&lang=1&uc=1>) dhe në të njëjtën kohë, Banka nuk do të llogarisë interes në interesin e kapitalizuar.

**15. A vlen Oferta edhe për pensionistët?**

Oferta është e vlefshme për të gjithë klientët që janë klasifikuar në kategorinë e rrezikut A, B ose C dhe nuk kanë status të kërkesave të dyshimta dhe të kontestuara (jofunksionale), gjegjësisht në raportin e deritanishëm me Bankën nuk janë vonuar më shumë se 90 ditë me shlyerjen e detyrimeve, përfshirë pensionistët.

Të gjitha detajet për Ofertën mund t'i shihni në linkun si vijon: <https://www.kb.com.mk/Default.aspx?sel=2370&lang=1&uc=1>

**16. Kushti për të mos pasur kredi jofunksionale (90 ditë) a vlen vetëm për kreditë në Bankën tuaj apo edhe për kreditë nga bankat tjera?**

Oferta publike vlen ekskluzivisht për kreditë në Bankën Komercijale.

**17. U mundova ta refuzoj Ofertën publike në mënyrë elektronike, por mora përgjigjen e mëposhtme: “Verifikimi i klientit është i suksesshëm. Ju nuk posedoni produkte krediti për persona fizikë që kualifikohen për ndryshim të kushteve kontraktuale në përputhje me Ofertën publike nr. 09-600-15831/1.”**

Oferta vlen vetëm për klientët që kanë ekspozim më 29.02.2020, në kategorinë e rrezikut A, B dhe C. Oferta është përgatitur në përputhje me dekretin e Qeverisë me fuqi ligjore dhe Vendimin për rrezikun e kredisë të BPRMV-së. Nëse keni kredi që ju është aprovuar në muajin mars 2020, nuk kualifikoheni për kushtet e kësaj Oferte.

**18. Unë do të doja të ju informoj se nuk kam nevojë për prolongim, ku ta refuzoj Ofertën?**

Klientët të cilët e REFUZOJNË Ofertën, dërgojnë njoftim për këtë edhe atë vetëm përmes NJËRËS nga mënyrat e ofruara si më poshtë:

**A. Njoftim i drejtpërdrejtë në formë elektronike duke plotësuar FORMULARIN në linkun në vijim <https://www.kb.com.mk/Default.aspx?sel=2310&lang=1&uc=47>**

Linku Ju çon tek formulari i gatshëm për njoftim, ku ju duhet të plotësoni numrin e llogarisë së transaksionit (15 shifra) dhe 6 shifrat e fundit të numrit tuaj amë (NUAQ). Pasi të keni shënuar këto të dhëna dhe pas verifikimit të tyre në bazën e Bankës do të hapet një dritare e re ku janë rradhitur të gjitha produktet e kredisë (si lëndë e Ofertës) që i keni në Bankë, dhe ju bëni zgjedhjen duke shënuar produktin e kredisë për të cilën ju e REFUZONI Ofertën. Përveç kësaj, krahas zgjedhjes suaj, duhet të shënoni edhe numrin e celularit tuaj dhe adresën e e-mailit për ndonjë kontakt eventual të ardhshëm. Deri në afatin e fundit të Ofertës, Ju mund të ndryshoni mendimin tuaj dhe të bëni zgjidhje të re, me çka do të duhet të llogoheni përsëri në formularin e shpallur.

OSE

**B. Njoftim me shkrim në adresën në vijim:**

Rr. Orce Nikolov nr. 3, 1000 Shkup, me shënim „Refuzim i Ofertës publike numër 09-600-15831/1 nga 30.03.2020”, ku në vetë dokumentin duhet të shënoni emrin dhe mbiemrin, datën dhe nënshkrimin tuaj, si edhe të gjitha produktet veç e veç dhe numrat e nën-llogarive për të cilat refuzohet Oferta:

- Numri i llogarisë së transaksionit ku është miratuar tejkalimi i lejuar
- Numri i të gjitha nën-llogarive kreditore veç e veç
- Numrat e fundit (6 shifrat) të numrit të kartës së kredisë

Të gjitha njoftimet me shkrim, të cilat do të pranohen në arkivin e Bankës në adresën e lartpërmendur ose të dërguara me postë me vulë postare në zarf gjatë afatit sa vlen Oferta, gjegjësisht deri në 09.04.2020, do të pranohen sipas vlefshmërisë së Ofertës.

**19. A vlen Oferta edhe për kredi me komision të paguara përmes Bankës Komercijale ndërsa të miratuara përmes Bankës për zhvillim të RMV dhe Agjencionit për punësim të RMV?**

Oferta nuk i përfshin kreditë me komision dhe kreditë tjera të miratuara përmes Agjencionit për punësim të RMV dhe Bankës për zhvillim të RMV.

**20. Kam kredi banesore, a ofrojnë masat e reja një mundësi për të rifinancuar dhe zvogëluar afatin e shlyerjes së kredisë pa harxhime noteriale dhe të avokatit?**

Sipas Ofertës Publike, masat e reja i referohen vetëm ri-programimit të kredive ekzistuese, respektivisht ofrojnë mundësi për periudhë grejs prej 6 muajsh në të cilën nuk do t'ju maturohen dhe nuk do të paguani këstet mujore të kredisë. Këto masa nuk do të thonë rifinancim i kredisë. Oferta mundëson lehtësim për 6 muajt e ardhshëm dhe për dallim nga rifinancimi realizohet pa vizituar Bankën, noterët dhe të ngjashme, gjë që është jashtëzakonisht e rëndësishme në këto rrethana të jashtëzakonshme. Në të njëjtën kohë, Oferta përfshin edhe një afat të prolonguar të pagesës prej 6 muajsh.

**21. Kam dërguar një kërkesë në Bankën Komercijale që të mos e pranoj Ofertën për prolongimin e kredisë. Dëshiroj të vazhdoj të paguaj si deri më tani. Më konfirmimi nëse keni pranuar kërkesën.**

Nëse gjatë dërgimit të njoftimit keni marrë një mesazh kthyes se e njëjta është dërguar në Bankë, nuk ka nevojë për konfirmim shtesë. Gjatë ri-regjistrimit në formularin në periudhën prej 10 ditëve Ju mund ti shihni përsëri nën-llogaritë kreditore të cilat i keni zgjedhur. Pas mbarimit të shpalljes, në vërtetimin/pasqyrën e bilancit të llogarisë Tuaj të transaksionit mund të shihni të gjitha produktet e zgjedhura të kredisë për të cilat keni refuzuar Ofertën.

**22. Pas mbarimit të periudhës grejs, lidhur me kreditë, a do të duhet përsëri të aktivizojmë urdhërin periodik për të na ndalur këstin prej rrogës apo do të aktivizohet në mënyrë automatike urdhër i ri periodik?**

Gjatë periudhës grejs, nëse nuk e refuzoni Ofertën, urdhëri periodik për pagesë të detyrimeve për kreditë do të vihet në pritje.

Pas mbarimit të periudhës grejs nuk do të ketë nevojë për nënshkrim të urdhërit të ri periodik.

**23. A do të më ndërpritet periudha grejs nëse e pranoj Ofertën për 6 muaj, dhe pas 3 muajve dëshiroj të paguaj këstin mujor?**

Oferta vlen për periudhën grejs prej 6 muajsh. Nëse e pranoni atë, në atë periudhë ju mund të bëni pagesë të kredisë sipas dëshirës, ndërsa mjetet e paguara do të kenë trajtimin e një pagese avans me të cilën do të ulet saldoja e kredisë në shtator 2020.

**Pyetje dhe përgjigje rreth kartave të kredisë për personat fizikë:**

**1. Si të di nëse i plotësoj kushtet për pagesa të shtyra të detyrimeve në bazë të përdorimit të kartave të kredisë?**

Kushtet i plotësojnë të gjithë personat fizikë shfrytëzues të kartave të cilët më 29.02.2020 janë klasifikuar në kategorinë e rrezikut shkronja A, B ose C nuk kanë status të kërkesave të dyshimta dhe të kontestuara. Kjo do të thotë që më 29 shkurt 2020, ju i keni shlyer detyrimet e Juaja ose keni borxh që nuk është shlyer ende, por vonesa nuk është më shumë se 90 ditë.

## **2. Çka do të thotë pagesa e shtyrë e detyrimeve për kartat e kredisë?**

Pagesa e shtyrë e detyrimeve mbi këtë bazë do të thotë që Banka nuk do t'ju llogarisë shumën minimale për pagesë gjatë periudhës sa zgjatën lehtësimi (prill - shtator 2020), respektivisht nuk do të jeni të detyruar për pagesa të rregullta mujore.

## **3. Çka pas periudhës grejs, kur do të më duhet të paguaj mjetet e shpenzuara gjatë kësaj periudhe?**

Duke filluar nga 01.10.2020, pas mbarimit të periudhës grejs, si bazë për llogaritjen e shumës minimale për pagesë të parashikuar në Marrëveshjen e kartës së kredisë, do të përdoret borxhi i llogarisë me gjendjen e 30.09.2020, kështu që në këtë gjendje do të përfshihen të gjitha shpenzimet Tuaja gjatë periudhës lehtësuese. Pagesa do të vazhdojë të bëhet si edhe para prolongimit.

## **4. A do të llogaritet interesi për llogarinë e kartës gjatë kësaj periudhe? A do të ketë edhe më tej periudhë pa interes për pagesat në tregti?**

Po, në periudhën grejs Banka do të llogarisë interesin si më parë. Por, periudha pa interes për transaksionet në tregti do të mbetet në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për secilin lloj karte krediti, deri në 40, 42, ose 45 ditë nga data e regjistrimit të transaksionit. Pas mbarimit të periudhës pa interes, Banka fillon të llogarisë interes edhe për këto transaksione, natyrisht, nëse ato nuk janë të mbuluara me pagesë.

## **5. A do të tërheq Banka mjete nga llogaria e transaksionit për pagesë të borxhit të kartës?**

Jo, gjatë kohëzgjatjes së lehtësimit, transferimet nga llogaria e transaksionit në kartë sipas urdhërit periodik, nuk do të realizohen.

## **6. A do të mundem të bëj vetë pagesa në llogarinë e kartës?**

Po, pagesat do të evidentohen si të hyra në llogari dhe do të janë në dispozicion të shfrytëzuesit të kartës për ripërdorimin e tyre.

## **7. Kam më shumë karta krediti, nëse e pranoj Ofertën, a vlen pagesa e prolonguar për secilën prej tyre?**

Për secilën kartë individuale ju mund ta pranoni ose refuzoni Ofertën e Bankës, respektivisht për ndonjërin të vazhdoni me pagesën e rregullt, ndërsa për një tjetër të pranoni pagesa të prolonguara.

## **8. A mund të më aprovoni periudhë grejs në periudhë prej 3 muajve, në vend të 6 muajve?**

Nëse e pranoni Ofertën, periudha grejs do të vlen për 6 muaj. Nuk ekziston mundësia për të ndryshuar kushtet e Ofertës ose për të pranuar vetëm një pjesë të tyre. Sigurisht, mbetet mundësia që me dëshirën tuaj të bëni pagesë në llogarinë e kartës, vlerën që ju dëshironi, kur të doni, ashtu që mjetet e paguara do ti keni në dispozicion për ripërdorim.

**9. Nëse e pranoj Ofertën, a do të marr edhe më tej vërtetim/pasqyrë bilanci për kartën?**

Po, do të vazhdoni të merrni vërtetim mujor me transaksionet e bëra gjatë muajit, shumën e llogaritur të interesit dhe anëtarësisë, me atë që shuma minimale për pagesë nuk do të llogaritet, gjegjësisht në vërtetim nuk do të keni shumën që llogaritet si përqindje e borxhit të përgjithshëm në fund të muajit për shkak të periudhës grejs.

**Pyetje dhe përgjigje rreth tejkalimit të lejuar**

**1. Nuk e di nëse do të marr rrogë/honorar në periudhën e ardhshme, a do të ma ndërpritni minusin e lejuar? Ka disa muaj që nuk marr rrogë/honorar, a do të ma ndërpritni minusin e lejuar?**

Nëse jeni të klasifikuar në kategorinë e rrezikut A, B dhe C, përfundimisht me 29.02.2020 dhe e keni pranuar Ofertën publike, Banka në periudhën deri më 30.09.2020, nuk do të ndërpresë tejkalimet e lejuara në llogaritë ku nuk do të ketë të hyra të rregullta mujore si roga, pensioni apo të hyra tjera.

**2. Së shejti më mbaron afati i vlefshmërisë së minusit të lejuar, çfarë të bëj?**

Nëse jeni klasifikuar në kategorinë e rrezikut A, B dhe C përfundimisht me 29.02.2020 dhe e keni pranuar Ofertën publike, Banka do të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së tejkalimit të lejuar deri në 30.09.2020.

**3. Gjatë kësaj periudhë a do të llogaritet interes në minusin e lejuar?**

Në periudhën 01.04. - 30.09.2020, Banka do të llogarisë dhe tarifojë interesin në përputhje me dispozitat e parapara në Marrëveshjen për tejkalim të lejuar. Për shumën e interesit të llogaritur dhe të paguar dhe kompensimet e rregullta mujore, Banka do të rrisë shumën e tejkalimit të lejuar dhe llogaria nuk do të ketë trajtim të minusit të palejuar.

**4. A duhet të nënshkruaj kontratë të re?**

Nëse e keni pranuar Ofertën publike, në periudhën 01.04. - 30.09.2020 nuk duhet të nënshkruhet kontratë e re për tejkalim të lejuar, ndërsa pas mbarimit të afatit më 30.09.2020, do të zbatohen dispozitat e rregullta të parapara në Marrëveshjen me të cilën rregullohet tejkalimi i lejuar.

**5. A mundem në çdo kohë ta kthej minusin e lejuar dhe ta ndërpres kontratën?**

Po, shuma e aprovuar e tejkalimit të lejuar mund të kthehet në çdo kohë, për çka ju duhet të paguani në llogarinë tuaj të transaksionit. Nëse nuk doni më ta shfrytëzoni tejkalimin e lejuar, duhet personalisht të bëni kërkesë në një nga ekspoziturat ose filialet tona.